



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr- 410-2002

Më datë 03.01.2025

Duke u bázuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 5 të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, e në zbatim të nenit 39, paragrafi 1 dhe 2, të Udhëzimit administrativ (MMPH) Nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e hartës zonale të Komunës, e konform nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e grupit punues

1. Formohet grupi punues për hartimin e Projekt-Rregullores për bonuset e zonimit për Komunën e Suharekës, në këtë përbërje:

- 1.1 Visar KUÇI-----Drejtoria për planifikim, urbanizëm dhe mjedis-----kryesues
- 1.2 Enver SHABANI---Drejtoria për shërbime publike dhe emergjencë-----anëtar
- 1.3 Gent GASHI-----Drejtoria për Inspeksion-----anëtar
- 1.4 Agim BYLYKBASHI---Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet-----anëtar
- 1.5 Avni BYTYÇI-----Zyra Ligjore e Komunës -----anëtar
- 1.6 Atdhe BUZHALA-----Zyrtar për gjeodezi dhe kadastër-----anëtar
- 1.7 Doruntina BYTYQI--Zyrtare e lartë për ndërtimtari-----anëtare
- 1.8 Sinan VRELLA-----Zyrtar i lartë ligjor në pronë -----anëtar
- 1.9 Elona KUQI-----Zyrtare për planifikim hapësinorë-----anëtare
- 1.10 Vjollca HOXHA-----Inspektore e ndërtimtarisë-----anëtare
- 1.11 Shqipron BYTYQI--Zyrtar Ligjor në pronë-----anëtar

2. Detyrë e grupi punues është që ta hartojnë Projekt-Rregulloren për bonuset e zonimit për Komunën e Suharekës dhe ti rekomandojnë Kryetarit të Komunës për vazhdim të procedurave të mëtejshme.

3. Në mbështetje të nenit 7, paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për kompensimin për kujdestari, punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës, **AUTORIZOHET** grupi punues i lartë cekur që të punojnë jashtë orarit të punës dhe ditëve të vikendit për hartimin e Projekt-“Rregullores për bonuset e zonimit për Komunën e Suharekës”.

4. Grupi punues për punën jashtë orarit të punës do të kompozohet konform nenit 7, lidhur me nenin 8, të Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për kompensimin për kujdestari, punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës, sipas Ligjit dhe akteve tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës që e rregullojnë këtë çështje.

5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen;  
Anëtarët e grupit punues  
Evidenca

Kryetari i Komunës  
**Bali MUHARREMAJ**